



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 17.10.2019)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
2. *Fatmira Luli* (anëtare)
3. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
4. *Illir Toska* (anëtar)
5. *Alban Toro* (anëtar)
6. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje *zonja Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Erjon Muharremaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Brunilda Kadi*, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe *zoti Medi Bici*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 2. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 3. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Atëherë, përshëndetje!

Jemi mbledhur për një mbledhje urgjente për një situatë urgjente.

Pavarësisht numrit jo të plotë. Në bazë të ligjit, kuorumi bëhet. Kështu që mbledhja mund të vazhdojë. Jemi mbi 7 anëtarë.

Në mbledhje prezent, jam unë Zëvendëskryetari drejtues i seancës, anëtari Dritan Hallunaj, anëtari Ilir Toska, anëtari Alban Toro, zonja Fatmira Luli, zonja Marçela Shehu dhe zonja Brikena Ukperaj.

Në vijimësi, fjala është për relatorin e çështjes, zotin Toska.

Fjala për ju!

Ilir Toska: Faleminderit!

Kjo mbledhje po bëhet me urgjencë për shkak të se ditën e sotme ka mbërritur një kërkesë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet për caktim gjyqtari në një çështje që është në lëndë penale. Ka të bëjë me një kërkesë për përjashtim gjyqtari, e cila sipas Kodit të Procedurës Penale, duhet të shqyrtohet brenda 48 orëve. Në këtë kuadër, konsideruam si Komision Karriere, të përfshinim edhe një çështje tjetër që është urgjente, e po kësaj gjykate, që ka mbërritur vetëm para pak ditësh. Edhe ajo është në lëndë penale dhe ka si objekt: “Dërgimin e çështjes në gjyq”.

I kemi përfshirë të dyja në relacionin përkatës për të konsideruar Këshilli të zbatojë vendimin e tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e

një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për sa kohë mekanizmi i skemës së delegimit është i pazbatueshëm për padisponueshmëri të gjyqtarëve në këtë skemë, ndërsa mekanizmi i transferimit të përkohshëm i gjyqtarit është i padobishëm, ndërsa kërkohet, nevoja që identifikohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet është vetëm në dy çështje, ku kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Referuar vendimit të tij si më lart, pra “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni propozon që gjykata nga duhet të pezgjodhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve, të jetë 1.

Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, zonja {...}, e cila ka pengesë ligjore për të gjykuar çështjen nr. 2, pasi është në përbërje të trupit gjykues, ku në atë rast është kërkuar përjashtimi i njërit prej gjyqtarëve. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe kryetari në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, zoti {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Atëherë, do të vazhdojmë me procedurat e shortit, për të pezgjodhur një nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, përjashtuar gjyqtarët {...} dhe {...}, që do caktohet për gjykimin e dy çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që janë...

Valbona Bako: {...}, {...} dhe {...}.

Ilir Toska: Pezgjodh emrin e njërit prej tyre.

Valbona Bako: {...}.

Ilir Toska: Atëherë, gjyqtari që u pezgjodh nga shorti është zonja {...}, që caktohet për 2 çështjet në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Faleminderit!

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, të vihet në dijeni kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtari që është caktuar. Hyn në fuqi menjëherë sapo të botohet në...

Lutem administrata të merret me përpilimin e dokumentacionit. Faleminderit!

Mbledhja mbyllet, nëse s'kemi gjë tjetër.

Ditën e mirë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor